Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

Buletini Nr. 14

Korrik 2019

- **Procesi i liberalizimit të tregut të energjisë dhe shtyrja e përkohshme e daljes në treg të një kategorie të konsumatorëve**
- **Përmbyllet me sukses Certifikimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST)–KOSTT**
- **Përshtatjet e rregullta vjetore për të Hyrat e Lejuara Maksimale**
- **Marrëveshje bashkëpunimi në mes ZRRE dhe OAK**
- **Përkujdesi ndaj konsumatorëve dhe shqyrtimi i ankesave**
- **Përfaqësimi i ZRRE në ngjarjet e rëndësishme për sektorin e energjisë**
- **Diskutimet publike**
- **Vendimet e Bordit të ZRRE janar – qershor 2019**

Adresa: Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org

Fjala Hyrëse nga Kryesuesi i Bordit të ZRRE

Arsim Janova
u.d. i Kryesuesit të Bordit të ZRRE

Të nderuar lexues,

Përmes Buletinit të 14 të Rregullatorit për Energji, po ju prezantojmë punën gjashtë mujore dhe angazhimin e Bordit dhe stafit të ZRRE-së në realizimin e detyrave dhe obligimeve për një rregullim sa më efikas të sektorit të energjisë.
Gjatë kësaj periudhe Bordi i ZRRE ka mbajtur 6 seanca në të cilat janë marrë mbi 60 vendime që kanë të bëjnë me çështje të ndryshme të rregullimit të sektorit të energjisë.
Si një ndër vendimet më të rëndësishme të kësaj periudhe ZRRE paraqet Certifikimin e Operatorit të sistemit të Transmetimit. Bordi i ZRRE, në mbledhjen e tij të dytë për këtë vit, të mbajtur me 15 shkurt 2019, ka marrë vendimin final për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST – KOSTT).
Me Vendimin final për Certifikimin e OST-KOSTT, i cili mbështetet edhe në Opinionin e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ZRRE-ja ka konfirmuar se ka ndarje të mjaftueshme të kontrollit mbi OST-në, prodhimin dhe/apo furnizimin e energjisë elektrike dhe që ky Operatorë i Transmetimit të energjisë elektrike vepron në përputhje me dispozitat e shthurjes, të përcaktuara me kapitujt IV dhe V të Direktivës 2009/72/EC1.

Me këtë vendim, ZRRE ka vërtetuar se OST, realizon funksionet e tij në mënyrë të pavarur nga çfarëdo biznesi tjetër në sektorin e energjisë dhe rrjedhimisht ofron qasje të lirë dhe jodiskriminuese në rrjetin e transmetimit për të gjithë operatorët e tregut të lirë që operojnë në territorin e Republikës së Kosovës.
Me këtë proces, ZRRE-ja ka përmbushur një nga obligimet më sfiduese që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë, duke dëshmuar edhe njëherë se është e përkushtuar në përmbushjen e funksioneve të sajë, për të siguruar një funksionim të duhur të tregut të lirë të energjisë elektrike në përputhje me direktivat e BE-së për energji dhe Traktatin e Komunitetit të Energjisë.
Si rregullator dhe monitorues i funksionimit të tregut energjetik në vend, ZRRE ka bërë vlerësimin e konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë dhe ka identifikuar se edhe pse aktualisht janë tetë [8] furnizues të licencuar për të furnizuar gjithë tregun me pakicë të energjisë elektrike, deri më tani, 7 nga këta nuk janë ende plotësisht aktiv dhe KESCO ende vazhdon të ketë 100% të pjesëmarrjes në furnizimin e tregut me pakicë të energjisë elektrike në vend. Pas analizimit të gjendjes së sektorit të energjisë pengesat në realizimin e kësaj faze janë mungesa e konkurrencës së mjaftueshme, për shkak të mos aktivizimit të furnizuesve me energji elektrike (përveç furnizuesit publik - KESCO), pamundësia që konsumatorët të gjejnë furnizues të tjetër, çmimet më të larta në tregun rajonal dhe më gjerë etj. Për këtë arsye, Bordi i ZRRE-së në seancën e datës 28 mars 2019, ka shqyrtuar kërkesat e palëve të interesuara dhe ka marrë vendim të amandamentoj Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, respektivisht nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 të këtij Udhëzuesi. Sipas këtij vendimi, për konsumatorët e kyçur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët është dashur të dalin në treg të parregulluar me datë 01 prill 2019, ju është shtyrë afati i daljes në treg deri më 31 mars 2020, ndërsa konsumatorëve të kyçur në nivelin e tensionit 10 kV, të cilët është dashur të dalin në treg të parregulluar me datë 01 prill 2020, iu shtyhet afati deri më 31 mars 2021.
Po ashtu në këtë buletin ZRRE ofron informata për shqyrtimet e përshtatjeve të rregullta vjetore për të Hyrat e Lejuara Maksimale si dhe shqyrtimet e ankesave dhe çështjeve të tjera që kanë të bëjnë me përkujdesjen e konsumatorëve dhe rregullimin e sektorit të energjisë.

Procesi i liberalizimit të tregut të energjisë dhe shtyrja e përkohshme e daljes në tregun e hapur të një kategorie të konsumatorëve

Pas miratimit të ligjeve të energjisë nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2016, një ndër kërkesat më themelore është liberalizimi i tregut në sektorin e energjisë. Po ashtu, ZRRE ka amandamentuar legjislacionin sekondar të sektorit të energjisë në harmoni me kërkesat e ligjeve të reja të energjisë, të cilat po ashtu janë në harmoni me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Në kuadër të këtyre ndryshimeve, ZRRE ka ndërmarrë veprime konkrete për hapjen e tregut të energjisë elektrike duke bërë aprovimin e Rregullës për Ndërrim të Furnizuesit, hartimin e Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike, aprovimin e Rregullës për Furnizuesin e Mundësisë së fundit, aprovimin e Rregullës për Vendosjen e të Hyrave për Furnizuesin me Shërbim Univerzal, përcaktimin e furnizuesit me obligim të shërbimit univerzal, përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit dhe licencimin e tetë [8] furnizuesve.

Deri më tani KESCO vazhdon të ketë 100% të pjesëmarrjes në furnizimin me energji elektrike në tregun e Republikës së Kosovës.

Sa i përket prodhimit, gjeneratorët publik janë të derregulluar që nga 1 prilli i vitit 2017, por kjo energji do të ofrohet në tregun e energjisë me shumicë, me prioritet për Furnizuesin e Shërbimit Universal (KESCO).

Duhet theksuar se përveç hapave të cekura më lartë në përmbushjen e kornizës rregullative, ZRRE ka ndërmarr edhe veprime tjera për të sqaruar dhe sensibilizuar konsumatorët dhe opinionin për nevojën e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike siç janë: identifikimi i konsumatorëve të cilët nuk e përmbushin kriterin për të gëzuar të drejtën për shërbim univerzal sipas kërkesave ligjore, dhe njoftimin e këtyre konsumatorëve për afatin dhe mënyrën e daljes në treg të parregulluar. Për të arritur këtë objektiv, ZRRE ka mbajtur takime me konsumatorët e kësaj kategorie, por edhe me odat ekonomike, dhe me klubin e prodhuesve të Kosovës, si palë të interesuara.

Përkundër këtyre aktiviteteve në drejtim të vënies së një pjese të konsumatorëve në tregun me çmime të parregulluara, ZRRE ka pranuar kërkesa të shumta nga konsumatorët, por dhe nga odat ekonomike që përfaqësojnë interesat e tyre, për shtyrje të afatit për liberalizim të tregut të energjisë elektrike, si dhe ka pranuar një rekomandim nga Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, i cili po ashtu ka kërkuar të shqyrtohet mundësia e shtyrjes së afatit për liberalizim të tregut.

Pas analizimit të gjendjes së sektorit të energjisë elektrike, ZRRE ka vërejtur se nuk ekzistojnë kushte të mjaftueshme për realizimin e kësaj faze të daljes në tregun e lirë të një kategorie të konsumatorëve të energjisë elektrike siç janë. Pengesat në realizimin e kësaj faze janë mungesa e konkurrencës së mjaftueshme për shkak të mos aktivizimit të furnizuesve me energji elektrike (përveç furnizuesit publik - KESCO), pamundësia që konsumatorët të gjejnë furnizues të tjetër, çmimet më të larta në tregun rajonal dhe më gjerë etj. Kështu dalja në treg e kësaj kategorie të konsumatorëve në këto rrethana, do të reflektonte me ngritjen e çmimit të energjisë elektrike për këta konsumatorë, duke i diskriminuar në krahasim me konsumatorët tjerë, me tarifa të rregulluara, duke ndikuar kështu edhe në funksionimin e bizneseve të tyre.

Për këtë arsye, Bordi i ZRRE-së në seancën e datës 28 mars 2019, ka shqyrtuar kërkesat e palëve të interesuara dhe ka marrë vendim të amandamentoj Udhëzuesin për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike të amandamentuar me 30 tetor 2018, respektivisht nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 të këtij udhëzuesi. Sipas këtij vendimi, konsumatorëve të kyçur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët është dashur të dalin në treg të parregulluar me datë 01 prill 2019, sipas amendamentimit të udhëzuesit iu shtyhet afati deri më 31 mars 2020, ndërsa konsumatorët e kyçur në nivelin e tensionit 10 kV të cilët është dashur të dalin në treg të parregulluar me datë 01 prill 2020, iu shtyhet afati deri më 31 mars 2021. Kushtet tjera të udhëzuesit mbetën të njëjta.

Seanca e IV e Bordit të ZRRE - 28 mars 2019

Certifikimi Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) – KOSTT

Pas aprovimit të opinionit të ECRB, në takimin e datës 15 shkurt 2019 Bordit i ZRRE ka nxjerrë vendimin për miratimin përfundimtar të Certifikimit të KOSTT SH.A. si Operator i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike në territorin e Republikës së Kosovës.

Bazuar në kërkesat që dalin nga Ligji 05/L-085 për Energjinë Elektrike - Nenit 12, Rregullës për Certifikimin e OST - Nenit 7, dhe në përputhje me modelin e shthurjes së pronësisë siç përcaktohet në Nenin 9 (6) të Direktivës së Energjisë Elektrike 2009/72/KE, ZRRE ka iniciuar procesin e Certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmisionit (OST) – KOSTT.

Certifikimi i OST është proces përmes të cilit ZRRE-ja konfirmon që ka ndarje të mjaftueshme të kontrollit mbi OST-në në njërën anë, dhe mbi prodhimin dhe/apo furnizimin në anën tjetër dhe që ndërmarrja e energjisë është në pajtueshmëri me dispozitat e shthurjes të përcaktuara me kapitujt IV dhe V të Direktivës 2009/72/EC1, kapituj këta të transpozuar në legjislacionin e Kosovës nëpërmjet nenit 11 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

Certifikimi i OST-ve kërkohet me qëllim të sigurimit që OST funksionet e tij i realizon në mënyrë të pavarur nga çfarëdo biznesi tjetër në sektorin e energjisë dhe rrjedhimisht të sigurohet që OST si i tillë ofron qasje të lirë dhe jodiskriminuese në rrjetin e transmetimit për të gjithë akterët që veprojnë në sektor.

Më datë 28 prill të vitit 2017 nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut SH.A., Rregullatori ka pranuar kërkesën/aplikacionin me anë të të cilit kërkohet Certifikimi si Operator i Sistemit të Transmetimit.

Pas lëshimit të vendimit preliminar me 24 shtator 2018, për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Rregullatori, zyrtarisht e ka dërguar në Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë (SKE), për shqyrtim dhe dhënien e opinionit në lidhje me Vendimin Preliminar për Certifikimin e OST/KOSTT.

Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë (ECRB) ka miratuar Opinioni e ECRB për vendimin e ZRRE-së në lidhje me Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST – KOSTT), si përgjigje ndaj vendimit preliminar të Bordit të ZRRE për certifikimin e KOSTT si Operator i vetëm i Sistemit të Transmetimit.

Me këtë proces, ZRRE-ja ka përmbush një nga obligimet më sfiduese që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë si dhe po vërteton edhe njëherë funksionimin e KOSTT në përputhje me direktivat e BE për energji brenda territorit të Republikës së Kosovës.



Përshtatjet e rregullta vjetore për të Hyrat e Lejuara Maksimale

Në seancën e IV të Bordit, të mbajtur me 28 mars 2019, Bordi i ZRRE ka aprovuar përshtatjet e rregullta vjetore për të Hyrat e Lejuara Maksimale (HLM) për vitin tarifor 2019 për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT-KOSTT), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH-KEDS) dhe Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU-KESCO). Bazuar në këto të hyra operatorët do të aplikojnë për tarifat e reja të shërbimeve të Transmetimit, Shpërndarjes dhe Furnizimit Universal të energjisë elektrike.

Pas aprovimit të përshtatjeve operatorët kanë aplikuar për tarifat e reja të energjisë elektrike të cilat janë aprovuar nga Bordi në seancën e V, e cila është mbajtur me 16 prill 2019.

Sipas vendimit të Bordit tarifat me pakicë për konsumatorët e rregulluar kanë mbetur të njëjta edhe për këtë vit tarifor (1 Prill 2019 – 31 mars 2020).

Tarifat e furnizimit me energji elektrike me pakicë për periudhën 1 Prill 2019 – 31 mars 2020

Grupi Tarifor	Niveli I tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Aprovuar 2019
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		11.19
		Fuqia e angazhuar	€/kW/muaj		5.85
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Lartë	4.92
			€c/kWh	Tarifë e Ulët	3.16
		Energjia reaktive (Q)	€c/kVArh		0.67
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		4.62
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.04
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Lartë	5.73
			€c/kWh	Tarifë e Ulët	3.69
		Energjia reaktive (Q)	€c/kVArh		0.67
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët me energji reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.57
		Fuqia e angazhuar	€/kW		2.97
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Lartë	6.69
			€c/kWh	Tarifë e Ulët	4.96
		Energjia reaktive (Q)	€c/kVArh		0.67
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.97
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e vetme	8.83
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Lartë	10.71
			€c/kWh	Tarifë e Ulët	5.30
5	0.4kV matësi 2 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e Lartë	6.75
			€c/kWh	Tarifë e Ulët	2.89
6	0.4kV matësi 1 tarifor (familjarë)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh		5.32
7	0.4kV (familjarë pa matës)	Konsumi i vlerësuar:			
		Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		1.74
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë mesatare	6.75
8	Ndriçimi Publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		3.21
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€c/kWh	Tarifë e vetme	9.24

Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë periudhës 1 tetor deri më 31 mars
Tarifa e lartë (ditë) aplikohet prej orës 08:00 - 23:00 gjatë periudhës 1 prill deri më 30 shtator
Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korespondon me cos(Φ)<0.95

Marrëveshje bashkëpunimi mes ZRRE dhe OAK

Me qëllim të rritjes së bashkëpunimit dhe ofrimit të mbështetjes në zhvillimin ekonomik në vend, sot me 29 janar 2019, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Odën e Afarizmit të Kosovës (OAK).

Përmes këtij memorandumi, ZRRE dhe OAK janë pajtuar, që në funksion të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik dhe social të asistojnë, promovojnë, përkrahin dhe të ngritin nivelin e bashkëpunimit reciprok në mes tyre.

Po ashtu ZRRE dhe OAK janë pajtuar që të këmbejnë informacione lidhur me aktivitetet e tyre dhe të bizneseve anëtare. Sipas memorandumit këmbimi i informacioneve do të bëhet në bazë të kërkesave të autorizuara të të dy palëve dhe në pajtim të plotë me ligjet në fuqi.

ZRRE përmes këtij memorandumi, ka theksuar edhe njëherë se do të ketë prioritet përfshirjen e të gjitha palëve, në proceset e shqyrtimeve të planeve zhvillimore të rrjetit të Transmetimit dhe Shpërndarjes si dhe gjatë proceseve të tjera rregullative që janë me interes të përgjithshëm.

Me këtë rast, u.d. i Kryesuesit të Bordit, Z. Arsim Janova, ka siguruar kryetarin e Bordit, Z. Skënder Krasniqi dhe përfaqësuesit e tjerë të OAK, se ZRRE do të vazhdojë të jetë transparente dhe në dispozicion të të gjitha palëve të përfshira në sektorin e energjisë, duke ofruar qasje të barabartë dhe pa diskriminim në proceset rregullative që ajo zhvillon.

ZRRE, përmes këtij memorandumi ka vënë në pah edhe njëherë rolin e saj, si një institucion i pavarur transparent dhe bashkëpunues me të gjitha palët e përfshira dhe të interesuara në sektorin e energjisë.

29 janar 2019 - Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes ZRRE dhe OAK

Përkujdesi ndaj konsumatorëve dhe shqyrtimi i ankesave të tyre në ZRRE

Në përputhje me nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energji është përgjegjëse për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve ndërmjet konsumatorëve dhe të licencuarve, ndërmjet dy të licencuarve, si dhe në lidhje me qasjen e palës së tretë në sistemin e transmetimit, apo shpërndarjes së energjisë elektrike, energjisë termike apo gazit natyror, si dhe transmetimit, rrjedhave ndërkufitare të energjisë elektrike dhe gazit natyror.

ZRRE gjatë periudhës janar - qershor 2019 ka regjistruar 50 ankesa të konsumatorëve të cilët kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre kundër përgjigjeve të lëshuara nga ana e Furnizuesit. ZRRE përveç ankesave të konsumatorëve të regjistruara dhe të zgjidhura, ka ofruar mbështetje edhe në dhënien e informacionit, shpjegimeve, konsultimeve verbale, postës elektronike, si dhe përmes telefonit për të gjithë konsumatorët e energjisë.

Gjatë periudhës janar – qershor 2019, ZRRE ka zgjidhur 110 ankesa të konsumatorëve, ku përfshihen edhe ankesat të cilat janë kthyer për rishqyrtim tek furnizuesi dhe operatori i sistemit të shpërndarjes.

Gjatë periudhës janar - qershor 2019 ZRRE ka pranuar edhe 10 ankesa të konsumatorëve përmes postës, të cilat edhe përkundër faktit që është dashur t'iu drejtohen të licencuarve apo gjykatave, insistimi i tyre ka qenë që t'i drejtohen Rregullatorit për zgjidhjen e ankesave të tyre. Natyra e këtyre ankesave kryesisht ka qenë për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, si dhe kompensim dëmi. ZRRE në kuadër të kompetencave të veta i'u është përgjigjur me shkrim konsumatorëve duke i udhëzuar të njëjtit për procedurat e mëtejme lidhur me ankesat e tyre

ZRRE përveç ankesave të regjistruara gjatë periudhës janar - qershor 2019 ka zhvilluar edhe 735 takime dhe 325 biseda telefonike me palët përfshirë edhe komunikimin elektronik, të cilët i janë drejtuar zyrës për çështje të ndryshme kontraktuale mes konsumatorit dhe ndërmarrjes së energjisë. Gjatë komunikimit me konsumatorët, ZRRE i ka njoftuar dhe udhëzuar ata për rregullat, procedurat si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre lidhur me furnizimin me energji.

Vendimet e Bordit të Rregullatorit në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve

Në bazë të Rregullës për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë, konsumatorët dhe të licencuarit kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë kundër vendimit të Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) si instancë e shkallës së parë në Bordin e Rregullatorit si instancë e shkallës së dytë.

Gjatë periudhës janar – qershor 2019 konsumatorët kanë parashtruar 2 ankesa në Bordin e Rregullatorit kundër vendimeve të Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve. Furnizuesi KESCO gjatë priudhës janar – qershor 2018 ka parashtruar 9 ankesa në Bordin e Rregullatorit kundër vendimeve të DMK.

Bordi i Rregullatorit gjatë periudhës janar – qershor 2019 ka shqyrtuar 2 rekomandime të nxjerra nga Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE për ankesat e konsumatorëve komercial dhe industrial, me ç'rast Bordi ka aprovuar të gjitha këto rekomandime

Përfaqësimi i ZRRE në ngjarjet e rëndësishme për sektorin e energjisë

ZRRE është pjesëmarrëse e rregullt në shumë aktivitete të komunitetit të energjisë si Këshilli i Ministrave (KM), Grupi i përhershëm i nivelit të lartë (GPNL-ang. PHLG), Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë (ECRB), Sekretariati i Komunitetit të Energjisë i vendosur në Vjenë, dhe katër forumet këshilluese: për energji elektrike, gaz natyror, çështjet sociale dhe naftën.

Përveç takimeve të rregullta të këtyre grupeve ZRRE merr pjesë edhe në punëtoritë që organizohen nga Sekretariati i komunitetit të energjisë si dhe ka marrë pjesë në Forumin e Athinës me 29 dhe 30 maj 2019.

Po ashtu përfaqësues të ZRRE kanë marrë pjesë në takimet me përfaqësuesit e Shqipërisë lidhur me formimin e PX (Power exchange –shkëmbim i energjisë) dhe bashkimin e tregut Kosovë – Shqipëri (Market coupling), që janë edhe kërkesa nga komuniteti i energjisë. Takimi i fundit me përfaqësuesit e Shqipërisë është mbajtur me 6 qershor 2019.

Me datë 18.06.2019 përfaqësuesi i DMK-së ka marr pjese në tryezën punuese e cila është organizuar nga MEDREG dhe ECRB ne Tiranë mbi "Ardhmëria e matjes neto dhe mbështetja e energjisë së ripërtëritshme- Mekanizmi i ankandit në MEDREG dhe ECRB. Përfaqësuesi i ZRRE ne këtë tryeze punuese ka qenë i ftuar nga Sekretariati i Komunitetit te Energjisë ne cilësinë e panelistit duke prezantuar mbi kornizën Rregullative të konsumatorëve prodhues apo gjeneratorëve per vet konsum ne shtetet anëtare te ECRB, ne fokus te veçantë rasti i Republikës se Kosovës.

Tiranë - 18 qershor 2019 - Tryeza e organizuar nga MEDREG dhe ECRB "Ardhmëria e matjes neto dhe mbështetja e energjisë së ripërtëritshme- Mekanizmi i ankandit në MEDREG dhe ECRB"

Pjesëmarrja e ZRRE në Asociacionin e Grave në Sektorin e Energjisë së Kosovës

Asociacioni i Grave në Sektorin e Energjisë së Kosovës doli si rezultat i rrjetit të mentorimit mCircle të krijuar në vitin 2016 për gratë në institucionet e sektorit të energjisë në Kosovë. AGSEK u lansua publikisht në qershor 2017 me mbështetjen e projektit të USAID, REPOWER-KOSOVO dhe është organizata e parë dhe e vetme e shoqërisë civile në Kosovë që fokusohet në gjininë në sektorin e energjisë. Institucionet partnere që mbështetën iniciativën përfshinin: Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), Operatorin e Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) dhe Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE).

Zyra e Rregullatorit për Energji synon të avancojë diversitetin gjinor dhe të përgjigjet në sfidat me të cilat ballafaqohen gratë në sektorin e energjisë, duke përfshirë nënpërfaqësimin në mjediset profesionale duke promovuar zhvillimin profesional të tyre.

ZRRE i ka ofruar AGSEK-it hapësirën e saj dhe përkrahjen teknike dhe profesionale për realizimin e takimeve virtuale me WRISE (Women of Renewable Industries and Sustainable Energy) dhe Asociacione të njëjta në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Takimi virtual në mes përfaqësueseve të AGSEK dhe WRISE

Kontributi i ZRRE në programin e REPOWER për mbështetje të studentëve

Zyra e Rregullatorit për Energji është partnere kyçe në programin e praktikës së studentëve të siguruar përmes projektit REPOWER/USAID, për të ofruar profesionistëve të ardhshëm të sektorit të energjisë mundësinë që të njihen më mirë me proceset dhe zhvillimet brenda institucioneve të sektorit të energjisë.

ZRRE ka përcjellur 6 cikle të praktikës së studentëve nga Universiteti i Prishtinës dhe RIT Kosova (AUK), duke ndihmuar që ekspertiza e saj të bartet në gjeneratën e ardhshme të profesionistëve. Praktikantët kanë fituar njohuri dhe përvojë të mirë të industrisë dhe fushës së rregullimit duke punuar drejtpërdrejt me ekspertët.

Detyrat e tyre kanë përfshirë menaxhimin e furnizimit me energji përmes analizave e faktorëve që ndikojnë në çmimet e tregut, zhvillimin e modeleve të tregut të energjisë, përgatitjen e raporteve të monitorimit dhe analiza shtesë të procesve tarifore. Përveç punës teknike në DTÇ dhe DTE, praktikantët kanë fituar përvojë në DLL, duke siguruar që korniza ligjore dhe rregullativ të jetë në përputhje me pakon legjislative për tregun e energjisë në Bashkimin Evropian. Gjithashtu në DMK, praktikantët nga afër janë njoftuar me problemet e konsumatorëve, duke siguruar mbështetje të plotë në fushën e ndihmës administrative, duke pranuar ankesat e konsumatorëve dhe duke bërë regjistrimin e tyre.

Shqyrtimet publike

Gjatë përmbushjes së obligimeve që ka ZRRE, në hartimin dhe aprovimin e legjislacionit sekondar si dhe të shqyrtimeve të tjera rregullative, me qëllim të përfshirjes dhe informimit të të gjitha palëve të interesuara, ZRRE publikon dhe zhvillon konsultime te ndryshme publike. Gjatë periudhës gjashtë mujore, janar – qershor 2019, ZRRE ka zhvilluar 4 diskutime të tilla publike.

Me 6 shkurt 2019, ZRRE ka vendosur në diskutim publik draft dokumentin për Vendosjen e Obligimit të Shërbimit Publik për Siguri të Furnizimit. Ky dokument përshkruan kriteret për matjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike, Procesin për vlerësimin e vendosjes së obligimit të shërbimit publik dhe Taksën për Sigurinë e Furnizimit mbi furnizuesit.

ZRRE gjatë procesit të Përshtatjeve të Rregullta Vjetore për të Hyrat e Lejuara Maksimale (MAR) për vitin tarifor 2019 për Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (OST/OT, KOSTT), Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH, KEDS) dhe Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU), janë përgatitur raportet konsultative me propozimet fillestar për MAR-et e azhurnuara:

- Raporti Konsultativ FSHU 2019
- Raporti Konsultativ KOSTT 2019
- Raporti Konsultativ OSSH 2019

Me qëllim të konsultimit me të gjitha palët e interesuara, raportet e lartpërmendura janë nxjerr në diskutim publik me 22 shkurt 2019 .

Me 26 prill 2019, ZRRE ka vendosur në diskutim publik draftin e Rregullës Standardet e Cilësisë së Shërbimit të Energjisë Elektrike. Qëllimi i nxjerrjes së Rregullës për Cilësinë e Standardeve të Shërbimit të Energjisë Elektrike është të përcaktohen treguesit e cilësisë së shërbimit të energjisë elektrike për konsumatorët, lidhur me shërbimet e ofruara, furnizimin e pandërprerë të energjisë elektrike dhe cilësinë e tensionit. Pas pranimit dhe shqyrtimit te komenteve nga palët e interesuara, Bordi i ZRRE me 5 qershor ka marrë vendim për aprovimin e Rregullës për Cilësinë e Standardeve të Shërbimit të Energjisë Elektrike.

ZRRE, me 2 maj 2019, ka vënë në diskutim publik Raportin Konsultativ për "Mekanizmin e Mbështetjes për caqet e BRE-ve (20 MW Solare Fotovoltaike)". Ky raport është përgatitur në pajtim me kompetencat dhe obligimet e ZRRE të përkufizuara në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energji, Ligjin për Energji Elektrike dhe legjislacionin sekondar që rregullon sektorin e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë. Rishqyrtimi i këtyre mekanizmave ka ardhur si rrjedhojë e rishikimit të Udhëzimit Administrativ 05/2017, për caqet e BRE-ve nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës përmes Ministrisë për Zhvillim Ekonomik.

Vendimet e Bordit të ZRRE janar – qershor 2019

V_1160_2019 – Vendimi për PEZULLIMIN e pranimit të aplikacioneve për marrje të autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese, për tu trajtuar si "aplikacione në pritje" , dhe për tu përfshirë në Skemën Mbështetëse, jashtë caqeve të BRE-ve

V_1159_2019 – Vendimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, Komuna e Novobërdës

V_1158_2019 - Vendimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, Komuna e Podujevës

V_1157_2019 - Vendimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, Komuna e Pejës

V_1156_2019 – Vendimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, Komuna e Gjakovës

V_1155_2019 – Vendimi për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, Komuna e Vushtrrisë

V_1154_2019 – Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar, shoqërisë "SUN ENERGY" SH.P.K., Projekti Sun Energy 5

V_1153_2019 – Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar, shoqërisë "SUN ENERGY" SH.P.K., Projekti Sun Energy 4

V_1152_2019 – Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar, shoqërisë "SUN ENERGY" SH.P.K., Projekti Sun Energy 3

V_1151_2019 - Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar, shoqërisë "SUN ENERGY" SH.P.K., Projekti Sun Energy 2

V_1150_2019 - Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar, shoqërisë "SUN ENERGY" SH.P.K., Projekti Sun Energy 1

V_1149_2019 - Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar, shoqërisë "Alpha Solar" L.L.C., Projekti Alpha Solar 3

V_1148_2019 - Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar, shoqërisë "Alpha Solar" L.L.C., Projekti Alpha Solar 2

V_1147_2019 - Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar, shoqërisë "Alpha Solar" L.L.C., Projekti Alpha Solar 1

V_1146_2019 - Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar, shoqërisë "BP SOLAR" L.L.C., Projekti BP Solar 3

V_1145_2019 - Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar, shoqërisë "BP SOLAR" L.L.C., Projekti BP Solar 2

V_1144_2019 - Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar, shoqërisë "BP SOLAR" L.L.C, Projekti BP Solar 1

V_1143_2019 - Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar, shoqërisë "D-ENERGY" SH.P.K., Projekti D-Energy 3

V_1142_2019 - Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar, shoqërisë "D-ENERGY" SH.P.K., Projekti D-Energy 2

V_1141_2019 - Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar, shoqërisë "D-ENERGY" SH.P.K., , Projekti D-Energy 1

V_1140_2019 - Vendimi për lëshimin e Licencës së PËRKOHSHME për prodhim të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë nga Hidrocentrali "Lepenci 3", ndërmarrjes "Hidroenergji"

V Licencë për prodhim të EE për ndërrmarrjen "Hidroenergji shpk"

V_1137_2019 – Vendimi për aprovimin e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët me Shërbime Universale të Furnizimit, që do të zbatohen nga i licencuari KESCO SH.A., duke filluar nga data 1 prill 2019 deri në shqyrtimin e rregullt tarifor

V_1136_2019 Vendimi për aprovimin e tarifave për shfrytëzimin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH/KEDS) për periudhën 01 prill 2019-31 mars 2020

V_1135_2019 - Vendimi për aprovimin e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit, operatorit të sistemit dhe tregut (KOSTT SH.A), për periudhën 01 prill 2019-31 mars 2020.

V_1134_2019 - - Vendimi për aprovimin e kërkeses së aplikuesit Rr. D. për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike

V_1133_2019 - Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar, shoqërisë NP "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A. – Gjakova

V_1132_2019 – Vendimi për lëshimin e licencës për Furnizim me Energji Elektrike ndërmarrjes Enerco LLC SH.P.K

V_1127_2019 – Vendimi për Aprovimin e të HYRAVE MAKSIMALE TË LEJUARA për Furnizuesin e Shërbimit Universal (FSHU/KESCO)

V_1126_2019 - Vendimi për Aprovimin e të HYRAVE MAKSIMALE TË LEJUARA që do të mbulohen nga

Operatori i Licencuar i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) KEDS SH.A.

V_1125_2019 - Vendimi për Aprovimin e të HYRAVE MAKSIMALE TË LEJUARA që do të mbulohen nga Operatorit Sistemit të Transmetimit dhe Tregut-KOSTT SH.A.

V_1124_2019 – Vendimi i kërkesës së shoqërisë "Hydro Line" SH.P.K.

V_1123_2019 – Vendimi për kërkesën e shoqërisë "Hydro Line" SH.P.K.

V_1122_2019 - Vendimi për kërkesën e shoqërisë "KelKos Energy" SH.P.K.

V_1121_2019 – Venimi për NDËRPREJE DHE SHKYÇJE nga Rrjeti i Sistemit të Transmetimit (KOSTT), Gjeneratorit HC Lumëbardhi II., të shoqërisë Kelkos Energy SH.P.K

V_1120_2019 – Vendimi për OBLIGIMIN – shoqëria KelKos Energy SH.P.K. që brenda nëntëdhjetë (90) ditësh, nga data e lëshimit të këtij Vendimi të pajiset me Certifikatë të Përdorimit dhe Leje Mjedisore nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

V_1118_2019 – Venimi për pranimin e Ndryshimit të emrit të ndërmarrjes së licencuar për Furnizim me energji elektrike nga "HEP-KS SH.P.K" në "HEP Energjia" SH.P.K. në Licencën për Furnizim me energji elektrike, me numër ZRRE/Li_43/15, të lëshuar me datë 14.10.2016 (e vlefshme për periudhën nga data 14 tetor 2016 deri 13 tetor 2021).

Vendimi për Licencë për furnizim me Energjisë Elektrike, ndërmarrja "HEP Energjia" sh.p.k. -

V_1117_2019 - I LËSHOHET LICENCA për prodhim të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë nga Parku me Erë "Kitka", ndërmarrjes "Air-Energy" SH.P.K, me numër licence ZRRE/Li_62/19.

Licencë për prodhim të Energjisë Elektrike, ndërmarrja "Air-Energy" sh.p.k.

V_1116_2019 - Venimi për Aprovimin e kërkesës së shoqërisë NPN"Renelual Tahiri" SH.P.K., dhe SHTYHET afati i vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V_891_2017 për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Orqusha, ZK Orqushë, me kapacitet të instaluar prej 4 MW, komuna e Dragashit.

V_1115_2019 Venimi për Aprovimin e kërkesës së shoqërisë "Eurokos JH" SH.P.K., dhe SHTYHET afati i vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V_882_2017 i Modifikuar me Vendimin V_1055_2018 ër vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë
elektrike nga Hidrocentrali HC Restelica 3, në Lumin Restelica ZK Krushevë dhe Glloboqic, me kapacitet të instaluar prej 2.35 MW, komuna e Dragashit.

V_1114_2019 – Vendimi për Aprovimin e kërkesës së shoqërisë "Eurokos JH" SH.P.K., për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V_881_2017 i Modifikuar me Vendimin V_1054_2018 për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Brodi 1, në Lumin Brod ZK Brod.

V_1113_2019 - – Vendimi për Aprovimin e kërkesës së shoqërisë "Hydro Line" SH.P.K. për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimin V_757_2016, i vazhduar me vendimin V_935_2018 për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, HC Albaniku 2, me kapacitet të instaluar prej 3.556 MW, në lokacionin "Batahir", ZK Batahir, komuna e Mitrovicës.

V_1112_2019 - Vendimi për Aprovimin e kërkesës së shoqërisë "Matkos Group" SH.P.K. për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V_760_2016, i vazhduar me vendimin V_934_2018, për vazhdimin e ndërtimit të Hidrocentralit HC Shtërpce me kapacitet të instaluar prej 5.031 MW, ZK Shtërpce, komuna e Shtërpcës.

V_1111_2019 - Vendimi për Aprovimin e kërkesës së shoqërisë "Matkos Group" SH.P.K për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së autorizimit Final V_759_2016, i vazhduar me vendimin V_933_2018, për vazhdimin e ndërtimit të Hidrocentralit HC Sharri me kapacitet të instaluar prej 6.453 MW, ZK Shtërpce, komuna e Shtërpcës.

V_1110_2019 - Vendimi për Aprovimin e kërkesës së shoqërisë "Hidroenergji" SH.P.K., për shtyrje afati i vlefshmërisë së Autorizimin Final V_755_, i vazhduar me vendimin V_930_2018 dhe i Modifikuar me Vendimin V_919_2017, për vazhdimin e ndërtimit të Hidrocentralit HC Lepenci 3 me kapacitet të instaluar prej 9.998 MW, Lokacioni Sllatinë, ZK Sllatinë, komuna e Kaçanikut.

V_1109_2019 - Vendimi për Aprovimin e kërkesës së shoqërisë "Hidroenergji" SH.P.K., dhe SHTYHET afati i vlefshmërisë së Autorizimin Final V_754_2016, i vazhduar me vendimin V_931_2018 për vazhdimin e ndërtimit të Hidrocentralit HC Lepenci 1 me kapacitet të instaluar prej 9.98 MW, Lokacioni "Uji i Thartë", ZK Pustenik, komuna e Hanit të Elezit.

V_1108_2019 - Vendimi për Aprovimin e kërkesës së shoqërisë "2 Korriku" SH.P.K., dhe SHTYHET afati i vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V_880_2017 për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Soponica, ZK Doganaj.

V_1107_2019 - VENDIMI PËR MIRATIMIN PËRFUNDIMTAR TË CERTIFIKIMIT të KOSTT SH.A.

V_1103_2019 – Vendimi për aprovimin e kërkesës së KOSTT për emërimin e z. Labinot Gashi - Kryesues i Komisionit Qeverisës të Kodeve Operacionale (KQKO).

V_1102_2019 – Vendimi për aprovimin e amandamentimit të dokumentit "Kodi i Standardeve Elektrike" të KOSTT Sh.a

V_1101_2019 – Vendimi për aprovimin e kërkesës së KOSTT SH.A. për Derrogimet e dispozitave të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes, Rregullave të Tregut dhe Licencës së OST

V_1100_2019 – Vendimi për Lëshimin e Autorizimit Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, ZK Llabjan, në Komunën e Pejës;

V_1099_2019 – Vendimi për Lëshimin e Autorizimit Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, ZK Sverrkë, në Komunën e Pejës;

V_1098_2019 – Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, ZK Sverrkë, në Komunën e Pejës;

V_1097_2019 - Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese kompanisë "Jaha Extra Beton" SH.P.K., për zhvillimin e projektit për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, ZK Sverrkë, në Komunën e Pejës;

V_1096_2019 - Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese kompanisë "Jaha Extra Beton" SH.P.K., për zhvillimin e projektit për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike në ZK Sverrkë, në Komunën e Pejës;

V_1095_2019 - Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese shoqërisë "EDK" SH.P.K., për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, Fusha Erçeves, ZK Sverrkë, në Komunën e Pejës;

V_1094_2019 – Vendimi për Lëshimin e Autorizimit Preliminar shoqërisë "EDK" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltmehdiaike, Projekti SUNPOWER 1 në vendin e quajtur Fusha Erçeves, ZK Sverrkë, në Komunën e Pejës

V_1093_2019 – Vendimi për lëshimin e Autorizimit Preliminar për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, Projekti KSOL në vendin e quajtur Fusha Erçeves, ZK Sverrkë, në Komunën e Pejës;

V_1092_2019 – Vendimi për aprovimin e kërkesës së aplikuesit S. I për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Lokacionin rruga "Ilir Soba", Komuna e Gjakovës;

V_1091_2019 – Vednimi për aprovimin e kërkesës së Iniciativës për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë - IADK", për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në Lokacionin Sfaraçak i Ulët, Komuna e Vushtrrisë;

V_1090_2019 - Vednimi për aprovimin e kërkesës së shoqërisë N.N."DILLI - COM", për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimin Final V_869_2016 të datës 14 dhjetor 2016, për vazhdimin e ndërtimin të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Bresana HC Bresana, komuna e Dragashit

Zyra e Rregullatorit për Energji
Rruga: Dervish Rozhaja nr. 12
Prishtinë 1000, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 247 615
Mob: +386 (0) 49 78 70 80
Fax: +381 (0) 38 247 620
Email: info@ero-ks.org
Web: www.ero-ks.org

Për Konsumatorë:
Tel: +381 (38) 247 615 lok. 116
Fax: +381 (0) 38 247 620
Email: ankesa.dmk@ero-ks.org

Për çështje Ligjore, Licencim, BRE/Autorizim:
Tel: +381 (38) 247 615 lok. 114, 117, 118
Fax: +381 (0) 38 247 620
Email: legal-licensing@ero-ks.org